

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Eliminimi i ishujve 6-20 kV dhe energjizimi i zonave turistike ne qytetin e Elbasanit”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45231400-9 Puna e ndërtimit për linjat e energjisë elektrike

VLERA E FONDIT LIMIT: 44.592.133,41 (dyzet e kater milion e peseqind e nentedhjete e dy mije e njeqind e tridhjete e tre presje dyzet e nje) lekë pa TVSH vënë në dispozicion nga te ardhurat e OSSH sh.a

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës nr. 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe nenit

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës në procedurën e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e perllogaritur e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. (neni 43, pika 2, germa "b" VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar)

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e perllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim

të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.“

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare , 2023, 2024, 2025 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” , ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: **i)** totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; **ii)** shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; **iii)** ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin nga organet e pushtetit lokal (Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore të maturuara për vitin 2025 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), sipas parashikimeve ligjore në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c. Vendosja e këtij

kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor për të vertetuar qe operatorët ekonomikë nuk kane pagesa te pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. *(neni 88, pikë 3 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar).*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.
 2. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.
- Konkretisht, për kontrata të realizuara me **ent publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- a) *Formular Vleresimi nga Investitori sipas Shtojës në DST për realizimin e punimeve*
 - b) *Kontrate Sipërmarrje*
 - c) *Situacionin përfundimtar*
 - d) *Akt kolaudimi objekti*
 - e) *Fatura tatimore të situacionit përfundimtar të deklaruar në organet tatimore*

➤ Konkretisht, për kontrata të realizuara me **sektorin privat**, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) *Formular Vleresimi nga Investitori sipas Shtojës në DST për realizimin e punimeve*
- b) *Kontrate Sipërmarrje*
- c) *Situacionin përfundimtar*
- d) *Akt kolaudimi objekti*
- e) *Fature tatimore të situacionit përfundimtar të deklaruar në organet tatimore*

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit;

- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoje duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Licenca profesionale të operatorit për realizimin e objektit të kontratës, të leshuara autoritetet kompetente shtetërore;

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri: Drejtoria Rajonale e OSSH, Berat

Adresa: Rr. "Antipatrea", pranë Gjykates Berat

Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për

Tel/Faks: 067 20 49 618

zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga autoritetet kompetente, e cila përfshin

E-mail: Armando.Roko@oshee.al

Web-faqe: eee.oshee.al

Per punimet e pergjithshme te ndertimit kompania duhet te kete licensat e meposhtme:

2. Kontaktet e personave pergjegjes per prokurimin:

• NP- 11- B. Ndertime per n/stacionet,kabinat e transformatoreve.linja e TN e te mesem
Emri: Armando Roko dhe shperndarjen e energjise.

E-mail: Armando.Roko@oshee.al

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë licensat e mëposhtme:

3. Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur -elektronik

4. Lloji i kontratës./Marveshjes Kuader: Pune

* Në rast të bashkimit të operatoreve ekonomike, Licensat profesionale duhet ti paraqesë

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: REF 81373-09-26-2023

Operatori ekonomik që ka marrë pjesë për punimet për të cilat kërkonet Licensa Profesionale.

6. Objekt i kontratës./Marveshjes Kuader: "Punim i ndertimit per te hapur te licencave TME U-ndertimkonon"

kategorite e kerkuara.

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 45231400-9 Puna e ndërtimit për linjat e

energjisë elektrike

8. Fondi limit: 83.000.000 (nëntëdhjetë e tre milion) lekë pa TVSH

9. Justifikimi, argumentat përkatës dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumentave

nuk korrespondon me të njëjtën numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një

operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës

Rekomandimin e APP ardhur me e-mail të datës 02.10.2023.

Argumentimi:

10. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet afati i ri i përcaktuar: Jo, nuk shtyhet afati.

Licencat profesionale përputhen me natyrën, përmasat dhe vlerën e punimeve të objektit të kontratës. Keto licenca dëshmojnë aftësinë profesionale të shoqërisë për zbatimin me sukses të

Bazuar në klasifikimin dy kategorisë është nënku 75 sipas jules 62 qe 23.12.2020. Për projektin

preventiv. Kërkesa për keto licenca profesionale është përcaktuar bazuar ne nenin 77 te ligjit

Public "Nëse ndryshimi i dokumenteve te tenderit behet ne qyrsim te pare te afatit te pranimit

te ofertave autoriteti ose enti kontraktor mund te zgjase afatin kohor te pritjes se ofertave

date 23.12.2020. Për miratimin e rregullave te prokurimit publik, si dhe VKM nr. 142, date

16.06.2008 për nevojën e zbatimit të rregullave të portës së ofertave

profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari

ndertimi". Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet,

Shënime: Këtu njoftimi duhet të bazohet në shprehjen e ndryshimeve në dokumentat e tenderit të

ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të

ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të punimeve për këtë objekt si me poshte:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P1	Punime germimi ne toke	Germim dheu per gropa shtyllash.Germim kanalesh ne toke te zakonshme.	A	0-20 milion leke
N.P11	Ndertime per N/stacione, kabina, transformatore, linja TN e te mesme dhe shperndarje e energjise	F.V. Terminale Kablli TM, F.V.në toke Kabell TM, F.V. Në shtyllë kabëll fuqie FV. Morseta F.V. Shtylla të centrifuguara betonarme F.V. Kapikorde tubolare AL	B	21-50 milion leke
N.S -18	Punime topogjeodezike	FV vendosje shtylla te centrifuguara. (Piketim shtyllash), piketim kanalesh per kalimin e kablllove	A	0-20 milion leke

2.3.3 Certifikatat e cilësisë që duhet të dorëzojnë operatorët:

- EN-ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent. (SSH EN ISO 9001:2015)
- EN-ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent.

SSH EN ISO 14001:2026 ose SSH EN ISO 14001:2015 (gjate periudhes se tranzicionit)

- Certifikatat e cilësisë sipas standartit SSH EN ISO 45001:2023 (Për sistemin e Menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalent.

objektet e te cilave te perputhen me objektin e prokurimit

*Te gjitha certifikatat e mesiperme duhet te jene te lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DAP).

*Operatori ekonomik mund të paraqesë certifikatat e mesiperme sipas standarteve shqiptare mbi konformitetin e standartit europian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatat e mesiperme ISO, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në aktmarrëveshje".

Argumentimi :

Lidhur me kriterin e kerkuar si me siper, komisioni eshte bazuar referuar Ligjit Nr.162 date:23.12.2020"Per prokurimin publik"neni 77,dhe neni 44,pika 1 te VKM nr.285,date 19.05.2021"Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik",ku nisur nga percaktimi I kerkesave per kualifikim per Operatorin Ekonomik bazuar ne aftesite teknike dhe profesionale citon se: *"Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit."*

Komisioni vendosi të kërkojë certifikatat e mësipërme për të vërtetuar që Operatori Ekonomik disponon licensat mbi menaxhimin e cilesise se punimeve,i lidhur ngushte me objektin e prokurimit duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

Sqarim : Nisur nga informacioni i marrë nga faqja zyrtare e DPS,nga azhurnimi aktual,rezulton se Certifikata e cilësisë sipas standartit SSH EN ISO 14001:2015(Për sistemin e menaxhimit të mjedisit)aktualisht është e shfuqizuar dhe është zëvendësuar nga Certifikata SSH EN ISO 14001:2026 (Për sistemin e Menaxhimit të mjedisit), ekuivalente.Por duke mbajtur në konsideratë periudhën e tranzicionit për këtë certifikatë,Operatori Ekonomik mund të paraqesë certifikatën e cilësisë SSH EN ISO 14001:2015(gjatë periudhës së tranzicionit),ose ekuivalent të vlefshme në datën e dorëzimit të ofertave

2.3.4 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të

deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtem:

- i. Librezë pune (përkatëse)
- ii. CV përkatëse
- iii. Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të cilat duhet të jenë në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.... (neni 26 i VKM, i ndryshuar)

Argumentimi :

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

VKM Nr.42 date:16.1.2008”Per miratimin e Rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”-kreu IV,pika 1/a dhe ligjit nr.8402 date 10.9.1998”Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”,neni 8 ku citohet:

Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore." Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane.

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si më poshte:

- 1 (nje) Inxhinier Elektrik

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder/ Gjeomatik

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin..... (neni 26 i VKM, i ndryshuar)

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike. Nevoja për inxhinierë në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Ne lidhje me aftësitë teknike, Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën sipas nje standarti te pershtatshem cilesie.Per sa me siper,eshte e nevojshme qe Operatoret ekonomike te pasqyrojne referenca te pershtatshme nga kontratat te zbatuara ne te shkuaren nga ana e tyre.

- **Inxhinieri i Ndërtimit:** është përgjegjës për punimet që kanë të bëjnë me betonimet e shtresat e betoni, çakul, etj.
- **Inxhinieri Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik:** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve gjeodezike që kanë të bëjnë me: piketime në lidhje me pozicionimin linjave nentokesore në terren.
- **Inxhinieri Elektrik:** është përgjegjës për zbatimin e projektit të miratuar, sipas kushteve teknike për punime në linja dhe kabina elektrike përcaktuar sipas Rregullores së Shfrytëzimit dhe Sigurimit teknik.

Argumentimi: Lidhur me disponueshmërinë e Inxhinierëve si më sipër, komisioni gjykon se për sa kohë që autoriteti kontraktor në preventivin e punimeve ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshme disponueshmëria e tyre, parë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor dhe referuar edhe volumeve të punimeve të parashikuar në preventivin dhe projektin përkatës dhe konkretisht:

- **Inxhinieri i Ndërtimit :** në mënyrë të përgjithshme është përgjegjës për punimet civile që kanë të bëjnë me betonimet e shtyllave,të linjave TM/TU në objekt,siguron zbatimin e kushteve të sigurisë.

- Inxhinieri Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik: në mënyrë të përgjithshme është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve gjeodezike që kanë të bëjnë me: piketime në lidhje me pozicionimin e shtyllave të linjave TM/TU në terren, kontrollon lartësitë e kabllit ABC, kontrollon përputhjen e punimeve.
- Inxhinieri Elektrik : është përgjegjës për zbatimin e projektit të miratuar, sipas kushteve teknike për punime në linja dhe kabina elektrike përcaktuar sipas Rregullores së Shfrytëzimit dhe Sigurimit teknik.

2.3.6 Fuqia punëtore e operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit të jetë minimalisht **25 punonjës**. Afati i punimeve duke gjykuar mbi natyrën dhe volumin e punimeve që do të kryhen do të jetë 72 ditë. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomike duhet të vetedeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjesve të ketkuar në formularin përmbledhës të vetedeklarimit.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- a) Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore shoqëruar me listëpagesat sipas formatit që kërkohet nga legjislacionin tatimor për 3 muajt e fundit të vitit ushtrimor (aktual).
- b) Liste pagesat e punonjesve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për 3 muajt e fundit të vitit ushtrimor (aktual) .

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatorët Ekonomik të Formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit, sipas shtojcës nr. 8 të DST-ve.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.... (neni 26 i VKM, i ndryshuar)

Argumentimi: Për përcaktimin e fuqisë punëtore për realizimin e këtij objekti, komisioni ju referua zerave të preventivit të punimeve si dhe afateve kohore të parashikuar në grafikun e punimeve dhe mbi bazën e analizave perkatese, është përcaktuar numri punonjesve që nevojitet për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë si më poshtë:

Komisioni përcakton se sipas zerave të punimeve nevojiten 14.133 ore pune në total referuar tabelës së përlogaritje bashkangjitur procesverbalit.

Total ore pune = 14.133 (referuar oreve të punës për çdo ze pune të preventivit)

Ore /1 ditë pune = 8 ore

Total ditë pune punëtori = 14.133 ore/8 ore = 1.767 ditë pune

Sipas grafikut të punimeve: 12 javë * 6 ditë = 72 ditë pune duhen për realizimin e objektit.

Numri i fuqisë punëtore të nevojshme = 1.767/72 ditë = 25 punonjes

Numri i punonjesve te nevojshem per realizimin e objektit sipas grafikut te punimeve te percaktuar eshte 25 punonjes ne total.

Numri i punonjësve është kërkuar duke ju referuar përmasave dhe specifikës së Investimit që do të kryhet. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve është mbajtur në konsideratë natyra e punimeve, volumi i punimeve, zona gjeografike që mbulon ky investim i parashikuar, afati i kryerjes së tyre duke përfshirë këtu edhe numrin total të punonjësve (Inxhinierë, teknikë, specialist, punonjës të kualifikuar, punëtorë të thjeshtë, punëtorët e mjeteve të rënda apo të thjeshta etj), e lidhur kjo me të vetmin qëllim të zbatimit të tij sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Lidhur me disponueshmërinë e pjesës tjetër të stafit teknik që është kërkuar (, elektrikist, , punonjës të kualifikuar, punëtorë të thjeshtë, punëtorët e mjeteve të rënda apo të thjeshta), nevojitet prezenca e tyre në objekt pasi nisur nga zërat e punimeve që do të kryhen ne objekt është një kërkesë e domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës: Si Psh : (2.37/5b-Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km / 4.176-Transport materiale elektrike me kamion me vinç-5-10 ton deri 20 km/, 3.498/b Germim dheu per gropa shtyllash T/L, ne toke te forte kat IV,~2.5 m, sip tabani 1.5m2, F.V shtylla të centrifuguara B/A cent. 9/6 m/kN,150/285 d1/d2 (me makineri)/ F.V shtylla të centrifuguara B/A cent. 9/15 m/kN, 220/355 d1/d2 (me makineri) / 4.04 M: Montim Transformatorë të fuqisë ÷ 560 kVA, 20/10/6/0.4 kV

- Teknikë/elektricist - janë të nevojshëm pasi bëjnë të mundur zbatimin e punimeve sipas projektit, zbatimin e masave të sigurisë elektrike në përputhje me rregulloren e punimeve në TM/TU, shkëputjen, izolimin dhe tokëzimin e pjesëve të tensionit gjatë punimeve, montimin e pajisjeve te ndryshme si: izolatorë, përçues, tirantues, aksesorë, montimin dhe lidhjen e kabllave TU, transformatorëve të fuqisë dhe pajisjeve ndihmëse, testime elektrike dhe kolaudime teknike si kryerjen e matjeve elektrike të tensionit, rrymës dhe izolimit pas përfundimit të punimeve.

- Punëtorët ndihmës – ndihmojnë në shtrirjen e kabllave, përgatitjen e vendit të punës dhe bartjen e materialeve.

- Eskavatorist – është e nevojshme në fazën civile të punimeve pasi bën të mundur hapjen e kanaleve për vendosjen e kabllave,bën të mundur gërmimin e themeleve për shtyllat e betonit,mundëson ngarkim,shkarkimin e materialeve të rënda.

- Automakinist – është i nevojshëm sepse transporton materiale elektrike si (kablllo, transformatorë, shtylla) nga magazina në objekt. Njëkohësisht transporton edhe materiale inerte dhe ndërtimore si (rërë, zhavor, beton) për punimet civile të kabinës. Gjithashtu shërben edhe për heqjen e materialeve të dëmtuara (gjatë fazës së prishjes ose gjatë fazës së rikonstruksionit).

Kriteri i mësipërm është në përputhje dhe në proporcion me volumin e kontratës si dhe në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuara,vlerën dhe natyrën e saj .

Njëkohësisht kriteri për stafin si me sipër,njëkohësisht lidhet ngushtësisht dhe është e diktuar edhe nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit dhe zërat e punimeve.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të pakten **7 punonjës** te specializuar/kualifikuar, te cilet duhet të jenë me statusin **elektriciste**, të pasqyruar në listepagesat e shoqërisë, të pajisur me kontratë pune, dëshmi profesionale (diplome, certifikata trajnimit etj) si dhe dëshmi kualifikimi të Sigurimit Teknik.

Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtëse në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – jo më pak se 25 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë – jo më pak se 2 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – jo më pak se 10 copë
- Ripa lidhës sigurimi për punime në lartësi – jo më pak se 7 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila – jo më pak se 2 copë

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin..... (neni 26 i VKM, i ndryshuar)

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

- Numri i fuqisë punëtore u llogarit duke u bazuar në volumnin e punimeve që duhen kryer sipas projekt-preventivit dhe afatit 72 ditë për kryerjen e punimeve. Në bazë të orëve të punës të marra nga analizat për secilin ze, u llogarit shifra prej 41 punonjës.
- Komisioni vlerëson se të pakten 7 punonjës duhet të jenë pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të leshuara nga Inspektoriati Qendror Teknik ose nga organi kompetent në bazë të ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” (të ndryshuar) me ligjin Nr.13/2013, datë 14.02.2013, të cilet të jenë elektrikist dhe me dëshmi përkatëse të formimit.
Keto dëshmi duhet të kërkojnë për shkak të natyrës së punimeve, punonjësit duhet të kenë njohuri të plota mbi elektroteknikën, njohuri të plota të Rregullores së Sigurimit Teknik Elektrik, mbi rregullat e përdorimit të mjeteve mbrojtëse që përdoren në linjat elektrike. Gjithashtu të kenë njohuri mbi impiantet elektrike (linjën elektrike), që të jenë të aftë për caktimin, se cilat elemente duhet të hapen për kryerjen e punimeve, dhe të dijë të veprojë në zbatimin e masave të domosdoshme të sigurimit teknik elektrik.
- Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë: 1 (një) Inxhinier Elektrik, 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, 1 (një) Inxhinier Gjeodet/topograf që të

mbikeqyrin punimet ne fazen e zbatimit. Keta inxhinier kane lidhje edhe me licencat profesionale qe duhen per zbatimin e projektit.

- Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.
- Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve

2.3.8 Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar në stafin 1 (një) mjek të përgjithshëm, bazuar në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e individuale të punës,
- diplomën universitare.
- licencën përkatëse për ushtrimin e profesionit.

Nëse OE nuk kanë në stafin e tyre persona përgjegjës me aftësi dhe kualifikimet e duhura lidhur me çështjet e shëndetit në punë (nëse nuk kanë mjek të punësuar) mund ti sigurojnë këto shërbime me anë marrëdhënieve kontraktore (të paraqitet kontrata e vlefshme, diploma universitare dhe licenca përkatëse për ushtrimin e profesionit) me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Është bazuar në përputhje me parashikimet e VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar, sipas të cilave, kompanitë që operojnë në fushën e ndërtimit, mund të sigurojnë shërbimet mjekësore për stafin e tyre, nëpërmjetë punësimit të një mjeku, apo nëpërmjet marrëdhënieve kontraktore me individë apo subjekte që operojnë që në këtë fushë.

2.3.9 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **4 (kater)** punonjës manovratorë të mjeteve të rënda nga të cilet **2 (dy)** automakiniste dhe **2 (dy)** eskavatoriste.

Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë në rast se mjete e punes (makinerite) janë në pronësi të operatorit.

Në rastet kur makinerite **disponohen me qira**, nuk është e nevojshme që manovratorët e mjeteve të figurojnë në listpagesat e shoqërisë. Në këtë rast ata duhet të kenë të vlefshme vetëm kontratën e punës dhe dëshmitë e drejtimit.

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues ,kapaciteti mbajtës minimum 5 (pese) ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine me kapacitet deri ne 3.5(tre pike pese) ton.	1 cope	Pronësi ose me qera
Autovinc / Kamion me vinc, kapaciteti mbajtes minimum 5(pese) ton.	1 copë	Pronësi ose me qera
Vinc kulle	1 cope	Pronësi ose me qera
Tokmak elektrik	1 cope	Pronësi ose me qera
Autobetoniere vetengarkuese 4x4	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Moto Gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera
Makine kosh	1 copë	Pronësi ose me qera
Minifadrome	1 copë	Pronësi ose me qera
Minidamper	1 copë	Pronësi ose me qera
Instrument per piketim (GPS)	1 copë	Pronësi ose me qera
Terameter	1 copë	Pronësi ose me qera
Megaohmeter	1 copë	Pronësi ose me qera
Kenotron per kabllot	1 cope	Pronësi ose me qera

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

Për mjetet e përmendura më sipër, drejtuesit e tyre të kenë leje drejtimi përkatëse.

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga Operatorët Ekonomik të Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8 të DST-ve.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.... (neni 26 i VKM, i ndryshuar)

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në bazë të punimeve që do të kryhen, nisur nga preventivi komisioni ka vlerësuar se mjetet e kërkuara janë të domosdoshme për përmbushjen e kontratës si më poshtë:

- Kamion vetëshkarkues, kapaciteti mbajtës minimum 5 (pesë) ton – është i nevojshëm për transportin dhe shkarkimin e dherave në objekt si dhe për mbushjen e kanaleve ose për mbushjen dhe mbrojtjen e kablllove. Kjo sjell një efikasitet dhe shpejtësi pasi lejon një zhvendosje të shpejtë të materialit, përdoret në terrene të vështira si në rastin konkret ku terreni rezulton në pjesën më të madhe të jetë kodrinor. Zëri në analizë: Transport element betoni dhe b/a me auto 10 km, Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km, Transport materiale elektrike me kamion me vinc 5 - 10 ton deri 20 km

- Kamionçinë me kapacitet deri në 3.5 (tre pikë pesë) ton – shërben për transportin dhe sistemimin e materialeve të ndërtimit, ku nuk mund të futen kamionat e mëdhenj me kapacitet mbajtës mbajtes mbi 5 ton, Zëri në analizë: F.V shtylla të centrifuguara B/A cent. 9/6 m/kN, 150/285 d1/d2 (me makineri)/ F.V shtylla të centrifuguara B/A cent. 9/15 m/kN, 220/355 d1/d2 (me makineri) / 4.04 M: Montim Transformatorë të fuqisë ÷ 560 kVA, 20/10/6/0.4 kV
- Autovinç, kamion me vinc, kapaciteti mbajtes minimumi 5 ton – është e nevojshme pasi shërben për ngritjen dhe montimin e shtyllave, të transformatorëve të kabinave elektrike, Montim "Box" parafabrikat (2l+1t). Zëri në analizë, Montim/demontim te Transformatorë të fuqisë ÷ 560 kVA, 20/10/6/0.4 kV, / 4.05-M , „Montim "Box" parafabrikat
- Vinç kulle – është një pajisje ndihmëse që shërben për ngritjen e pajisjeve të rënda dhe montimin e çmontimin e pajisjeve ekzistuese që do të demontohen. Zëri në analizë: F.V shtylla të centrifuguara B/A cent. 9/6 m/kN, 150/285 d1/d2 (me makineri)/ F.V shtylla të centrifuguara B/A cent. 9/15 m/kN, 220/355 d1/d2 (me makineri) / 4.04 M: Montim Transformatorë të fuqisë ÷ 560 kVA, 20/10/6/0.4 kV.
- Tokmak elektrik- Sherben per ngjeshjen e tokes dhe mbushjen e kanaleve pas germimit dhe hapjes se tyre. Zeri ne analize 3.47/1b, Mbushje, rafshim, ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, toke te zakonshme
- Autobetoniere vetengarkuese 4x4, është e domosdoshme për punimet e betonit për bazamentet e shtyllave, kabinave, kanaleve të kablllove. Zëri në analizë: 3.243-Struktura monolite betoni C 16/20.
- Vibrator – është e domosdoshme për ngjeshjen dhe kompaktimin e betonit për bazamentet që të mos krijohen boshllëqe. Zeri ne analize 3.243-Struktura monolite betoni C 16/20.
- Eskavator me goma 0.25 m³ - është i nevojshëm për hapje kanalesh për kablllo, themele për shtylla, gropa për bazamente/për pastrim ose rrafshim terreni. Njëkohësisht shërben edhe për ngarkim+shkarkim të materialeve (zhavor, rërë, dhe). Zëri në analizë: 3.498/b: Gërmim dheu për gropë shtyllash, T/L, në tokë të fortë kat. IV, ~2.5m, sip. tabani 1.5 m².
- Moto Gjenerator – nevojitet pasi shërben për furnizimin me energji të pajisjeve elektrike ose për testimet në terren të pajisjeve.
- Makine kosh- sherben per ngritjen e punonjesve ne lartesi, per kryerjen e punimeve te preventivit per zerat si me poshte, F.V. në shtyllë Kabell TM 10KV, XLPE, Al -3 x70mm²/ F.V. Në shtyllë kabëll fuqie 0.6/1kV, XLPE, AL-4x95mm²

- Minifadrome/Minidamper, sherbejne per kryerjen e punimeve per zerat 3.498/b:Gërmim dheu për gropë shtyllash,T/L,në tokë të fortë kat.IV,~2.5m,sip.tabani 1.5 m²., ne vende ku ka veshitësi ne manovrim per makinerite e medha
 - Instrument per pikezim (GPS) , sherben per pikezimin e shtyllave referuar zerave te punimeve :F.V shtylla të centrifuguara B/A cent. 9/6 m/kN,150/285 d1/d2 (me makineri)/ F.V shtylla të centrifuguara B/A cent. 9/15 m/kN, 220/355 d1/d2 (me makineri), 3.45/1 Gërmim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m², 3.87/a Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke
 - Terameter- sherben per matjen e rezistences se tokezimit, zeri AN, 4.25 Matje kontroll i Rezistences se tokezimit per nje shtylle
 - Megaohmeter, sherben per të testuar cilësinë e rezistences se izolimit të kabllove, zerat,4.44, F.V.në shtyllë Kabell TM 10KV, XLPE, Al -3 x70mm²/ F.V. Në shtyllë kabell fuqie 0.6/1kV, XLPE, AL-4x95mm²
 - Kenotron për kabllo – është i nevojshme pasi është një pajisje e cila teston izolimin e kabllove(kontroll i cilësisë para vendosjes së tij në objekt), zeri i punimeve 4.189 Kenotronim i kokave te kablilit per seksion (25 ÷ 240) mm², tension 24 kV.
- Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht:

1-Analizat e çmimeve te zerave te preventivit jane marre ne baze VKM nr. 216 date 13.04.2023,botuar ne fletoren zyrtare Nr.66 date:19.04.2023.

2 – Analizat teknike qe nuk jane ne VKM Nr.216 date 13.04.2023,jane hartuar si zera jashte liste bazuar ne librin Nr.6 "Montimi i linjave dhe nestacioneve elektrike"si edhe ne librin e “Normave komunale “.

3 - Çmimet e baze materiale jane marre ne baze te manualit te SAP-it-OSSH,studimit te tregut,bazuar ne mesataren e cmimeve te marra nga ky studim;ose cmimet e kontratave te meparshme te realizuara nga veteautoriteti Vendim nr.285 date 19.5.2021”Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik”.

4 - Volumet e gërmimeve, betonimeve dhe te montimeve jane marre sipas standarteve te OSSH Sh.a bashkengjitur projektit.

5 - Paga orare është marrë 484.90 lekë.

6 - Per punimet e montimit qe nuk jane ne manual i referohemi Udhezimit nr.2 date 08.05.2003”Per klasifikimin dhe strukturen e koston se punimeve te ndertimit”.

7 - Shpenzimet plotesuese jane marre 8 % sipas VKM nr. 216 date 13.04.2023,botuar ne fletoren zyrtare nr.66 date 19.04.2023

8 - Norma e fitimit eshte marre 10 % sipas VKM nr. 216 date 13.04.2023,botuar ne fletoren zyrtare nr.66 date 19.04.2023.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.3.10 Per Listen e meposhteme te artikujve:

- Shtylla të centrifuguara betonarme 10/10 m/kN, 180/330 d1/d2
- Kabell TM 10KV, XLPE, Al -3 x70mm².
- Kabell fuqie 20 kv alumin unipolar (flat) me izolim XLPE (1x240) mm²
- Terminal 20 kv me kapikorde AL-CU per seksion (70-240 mm²) unipolare per ambjent te brendshem
- UPVC Tub ø 160 mm² me parete te trasha , trashesia e paretit 9.5 per mbrojtjen e kabllit elektrik nen toke
- Muftë unipolare TM 24 kv per kabell te thate AL XLPE 1x(95-240) mm²
- Kapikorda tubolare CU me presim per percjelles 50 mm²
- Çele linje 24kv/630 A tip SF6
- Transformator fuqie

Operatori ekonomik duhet te paraqese:

- *Operatori ekonomik në rastin kur nuk është prodhues duhet të vërtetojë me marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon , fax, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike ose ekuivalenti i tij/saj) nga te cilat specifikimet teknike te produkteve te kerkuara te jene ne gjuhen e ofertes. Ne rastet kur marreveshjet jane ne gjuhe te huaj, duhet te behet perkthimi ne gjuhen shqipe dhe noterizimi i tij.*
- *Katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve (skedat teknike) te prodhuesit per listen e artikujve si me siper, ne te cilat te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen.*
- *Operatori Ekonomik ofertues duhet te paraqese deshmi te testimave zyrtare te kryera, te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi qe vertetojne pajtueshmerine e materialeve te prodhuara me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara (Test raportet per listen e mesiperme te artikujve, nese rezultojne ne gjuhe te huaj, duhet te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen-kjo sipas VKM Nr.285 date:19.5.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit Publik"*

Argumentimi: 1. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Autorizimi i prodhuesit është një

dokument i rëndësishëm, pasi përvecse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave.

Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e blerjes së mallit të sipercituar.

Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën e caktuar. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në treg. Përmes këtij kriteri, AK mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte. Gjithashtu kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plotë të prodhuesit, si numrat e telefonit, faksit, email-it, dhe faqes së internetit, AK ka mundësi të kontaktoje me prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë.

Kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

2. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit është i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara.

Paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të mallrave. Kjo siguron që AK ka një pamje të qartë për cilësinë dhe aftësitë e mallrave që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave.

Kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mallrat e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike.

Gjithashtu kriteri për përkthimin e specifikimeve teknike në shqip është i rëndësishëm për garantimin e një komunikimi të qartë dhe të kuptueshëm me Autoritetin Kontraktor në cilësinë e blerjes. Përkthimi i specifikimeve teknike në shqip siguron Autoritetin Kontraktor të kenë një kuptim të saktë të cilësive dhe karakteristikave të mallrave. Kjo ndihmon në zvogëlimin e gabimeve dhe keqkuptimeve të mundshme gjatë furnizimit të mallrave.

3. Kjo kerkese ne lidhje me testimet zyrtare eshte ne perputhje me piken 6/c, te nenit 40 te VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar.

Së pari, paraqitja e deshmive të testeve zyrtare siguron një burim të besueshëm të informacionit për cilësinë e mallrave. Testimet zyrtare janë kryer nga institucione të pavarura dhe të autorizuar ose nga prodhuesi i vetë mallrave, duke garantuar pavarësinë dhe besueshmërinë e rezultateve. Ky informacion është i rëndësishëm për AK për të siguruar që mallrat janë të pajtueshme me specifikimet dhe standardet e kërkuara.

Së dyti, kriteri për deshmitë e testeve zyrtare ndihmon në zvogëlimin e rreziqeve. Duke përdorur informacionin e testeve zyrtare, AK mund të identifikojë përparësitë dhe mangësitë e çdo oferte potenciale. Duke kërkuar paraqitjen e deshmive të testeve zyrtare, AK mund të sigurojë që të gjithë operatorët ekonomikë kanë një mundësi të barabartë për të demonstruar cilësinë dhe pajtueshmërinë e mallrave të tyre. Kjo nxit konkurrencën e drejtë dhe siguron që oferta më cilësore të fitojë kontratën.

2.3.11 Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të ketë te punësuar ne stafin e shoqërisë së tij:

- 1 Specialist që të disponojë Certificate si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”.

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.... (neni 26 i VKM, i ndryshuar)

Argumentimi: Ne baze të VKM nr. 108, datë 9.2.2011, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, në dispozitën III-pika 10.5 / 10.12 / 10.13 / dispozita IV-pika 7-a,b,b1,b2,b3,c1-shprehet qartësisht aftësitë që duhet të ketë punonjësi i ngarkuar për menaxhimin e riskut I cili duhet të plotësojë kushtet në lidhje me çështjet e sigurisë në punë.

Gjithashtu në perputhje me klauzolat e ligjit Nr.10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë” dhe VKM Nr.312 Dt: 5.5.2010 për “Miratimin e rregullores” Për sigurinë në Kantier”.

Vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që operatori ekonomik ,në këtë mënyrë lidhur me masat tekniko-organizative që do të ndërmarre, do të shmangëedhe rreziqet e mundshme që mund të shfaqen gjatë zbatimit të punimeve dhe do të realizojë ato sipas standarteve ligjore në fuqi.

Sqarim/Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat që do të vendosen në linjat elektrike që po prokurohen, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Keto specifikime jane te unifikuara per te gjitha institucionet e varesise te OSHEE GROUP SH.A

Kerkesat e parashikuara ne specifikimet teknike “Kerkesa te Detyrueshme” jane per mallrat te cilat do te vendosen ne linjat elektrike qe po prokurohen.

Keto kerkesa nuk plotesohen nga OE ne momentin e hapjes se ofertave, por ne momentin e zbatimit te punimeve dhe jane dokumenta qe shoqerojne materialet elektrike ne momentin e zbatimit te kontrates, te cilat kontrollohen gjate kohes se zbatimit, nga mbikqyresi i punime etj.

Termi “gjithe test raportet e fabrikes” nenkupton “test raportet e fabrikes” per te gjitha mallrat qe do te vendosen ne linjat elektrike, per te cilat eshte kerkuar nje gje e tille.

Diten e hapjes se ofertave OE me qellim marrjen pjese ne proceduren e prokurimit do ti referohen kerkesave te parashikuara ne DST-te.

- Standartet e perdorura ne specifikimet teknike jane konform kerkesave te standarteve te permendura SSH, IEC, EN, DIN ose cdo standart tjeter ekuivalent me to.

Sqarim: Cdo kriter i parashikuar ne nenin 26, piak 2 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) dhe ne shtojcen nr. 8 te Dokumentave Standarte te Tenderit, përmbushet nga Operatoret Ekonomik nepermjet paraqitjes se Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.

Ne baze te nenit 26 ,pika 6, i VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ” (i ndryshuar) , “ “Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në original ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.”.

Ne rast bashkimi te opratoreve ekonomik, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. (neni 88, pika 3 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ”)

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

NJESIA E PROKURIMIT